



Datë: 20.06.2025

Numër Protokolli: 4251/2025

A.nr.880/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtare, me Sabile Avdyli-, në cilësinë e procesmbajtëses duke vepruar sipas ankesës më numër A.nr.880/2025, të datës 14.05.2025, të parashtruar nga ankuesi E.C, kundër organit të punësimit, në Komuna e Kamenicës në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.880/2025, të datës 14.05.2025, të parashtruar nga ankuesi E.C.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil E.C, (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), i punësuar në Komunën e Kamenicës sipas Akt Emërimit të datës 14.08.2023, me datë 14.05.2025 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 3154/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin financiar për periudhën prej datës 09.09.2024 deri më datën 08.09.2025, i njëjti më datë 19.06.2025 ka tërhequr ankesën e datës 14.05.2025, me arsyetimin se i është bërë kompensimi sipas marrëveshjes për vëllim të shtuar të datës 06.02.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën A.nr.880/2025 të datës 14.05.2025 të parashtruar nga ankuesi në KPMSHCK; Kërkesa e datës 27.03.2024 për kompensim shtesë për vëllim të punës; Marrëveshja e datës 06.02.2025; Vendimi i datës 06.09.2024; Parashtrësën e ankuesit të datës 18.06.2025.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë plotësuar parakushtet ligjore që të **përfundoi procedimi administrativ** i filluar me ankesën e ankuesit, **sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Kryetari i Komunës së Kamenicës me datë 06.02.2025 ka nënshkruar marrëveshjen ku ka angazhuar zyrtarin E.C në punë shtesë për periudhën prej datës 09.09.2024 deri më 08.09.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesit sipas marrëveshjes së datës 06.02.2025, me datë 27.03.2025ka parashtruar kërkesë tek Kryetari i Komunës së Kamenicës për kompensim shtesë për vëllim të punës duke filluar nga muaji shtator 2024 deri në muajin shtator 2025.

Ankuesi, me datë 19.06.2026 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka përcjellë parashtrësë juridike, përmes së cilës deklarohet se i njëjti është tërhequr nga ankesa e tij e parashtruar përmes emalit kundër mos kompensimin e shtimit të vëllimit të punës prej muajit shtator 2024 deri muajin shtator 2025, me arsyetimin se i është ekzekutuar kompensimi sipas marrëveshjes për vëllim të shtuar të punës të datës 06.02.2025, ndërsa parashtesa e të njëjtit e datës 19.06.2025 në Këshill është protokolluar me numër:4175/2025.

Nisur nga rrethanat e paraqitura si më lartë, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë; 2. Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundohet, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë” dhe erdhi në përfundimin se ankuesi përmes parashtrësës së datës 19.06.2025 me numër protokolli:4175/2025 është tërhequr nga ankesa e tij e datës 14.05.2025 e parashtruar në Këshill, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se janë plotësuar parakushtet ligjore që të përfundohet procedimi administrativ si në dispozitivin e këtij vendimi, lidhur me ankesën e ankueses A.nr.880/2025 të datës 14.05.2025.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË
KOSOVËS
Lënda A.nr.880/2025**

Sabile AVDYLI

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit E.C;
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës Kosovës ; dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.